



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fond

RISHPALLJE
PËR DIZAJNIMIN E LOGOS FONDIT PËR SIGURIM SHËNDETSORE

Fondi i Sigurimit Shëndetësor (FSSH), shpall konkurs dhe fton të gjithë të interesuarit për të paraqitur idetë e tyre për logon e FSSH-së.

Konkursi është i natyrës garuese dhe ideja më e mirë e përzgjedhur do të shpërblehet me shumën 4.000.00 €.

Garuesi dhe ideja e dytë e përzgjedhur do të shpërblehet me shumën. 2.000.00 €.

Garuesi dhe ideja e tretë e përzgjedhur do të shpërblehet me shumën. 1.000.00 €.

Të gjitha të drejtat autoriale mbi logon e përzgjedhur, përpunimi dhe përdorimi i saj, barten nga autori tek Fondi i Sigurimit Shëndetësor.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga FSSH-së .

Aplikuesit, gjatë ideimit të logos duhet të ketë parasysh kërkesat e mëposhtme. Logoja duhet të:

- Jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- Jetë kuptimplotë dhe të shprehë funksionin, mandatin dhe detyrat e FSSH-së, bazuar në Ligjin për Sigurime shëndetësore 04/L-249.
- Ketë një pasqyrim artistik të veprimtarisë së FSSH-së;
- Jetë unike, të reflektojë vizionin, misionin dhe vlerat e FSSH-së;
- Kuptohet lehtësisht dhe të përçojë mesazh të qartë;
- Jetë e dallueshme, që i reziston kohës dhe e lehtë për tu mbajtur në mend;
- Jetë lehtë e përshtatshme në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, në internet dhe në shtyp, në sfonde të bardha dhe të errëta;
- Jetë e qartë edhe në madhësi të ndryshme, p.sh. shumë të vogël (vizitkarta) ose madhësi shumë të mëdha (billboard);
- Të jetë e përdorshme krahas stemës shtetërore dhe mos të krijojë duplikim të simbolit shtetëror as vizualisht dhe as artistikisht.
- Ne rast të përdorimit të plagjiaturës, autori do të mbajë përgjegjësin bazuar në Ligjin Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/1-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Konkurimi:

Dizajnet duhet të dorëzohen në pliko të mbyllur e cila brenda duhet të përmbajë:

- Punimet e printuara dhe në CD së bashku me manualin e shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit;
- Punimet duhet të përmbajnë vetëm një kod/shifër identifikuese dhe jo të dhënat personale të autorit;
- Të dhënat personale të autorit duhet të futen në një zarf tjetër të vogël i cili hapet vetëm pas përzgjedhjes së logos;
- Punimet e printuara dhe në CD duhet të vendosen në një zarf i cili duhet të përmbajë edhe zarfin e mbyllur me shënimet personale të autorit.
- Një autor mund të aplikojë me më shumë se një ide;
- Nëse një autor aplikon me më shumë se një ide, aplikimi bëhet me pliko të veçantë dhe kod/shifër të veçantë;

Punimet konkurruese nuk do të ju kthehen autorëve.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar FSSH-së .
Konkursi është i hapur prej datës. 16.04.2019 .deri me. 06.05.2019.

Punimet duhet të dorëzohen zarfa të mbyllur me shënimet e mëposhtme në adresën e mëposhtme:

Fondi i Sigurimit Shëndetësor

Adresa:, Lakërishtë, Rruga Tirana. Objekti'' Beni Dona''

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, Zyra Nr. 13

Në pliko duhet të shënohet:

Per: Fondi i Sigurimit Shëndetësor

Ref: Konkursi për dizajnimin e logos së FSSH-së

Për informata shtesë mund të na shkruani përmes emailit

Informata lidhur me mandatin, funksionin dhe detyrat : <https://fssh.rks-gov.net>

